

Rregullorja e Brendshme e Qendrës së Ndërmjetësimit

6 mars 2020

Përditësuar në përputhje me Amendimin nr. 1, datë 29 maj 2020



Përmbajtja

Rregullorja e Brendshme e Qendrës së Ndërmjetësimit	1
Përmbajtja	2
I. Hyrje.....	3
II. Baza Ligjore	3
III. Rregullat e Përgjithshme të Qendrës së Ndërmjetësimit	6
IV. Menaxhimi i rasteve.....	9
V. Tarifat	13



I. Hyrje

Kjo rregullore e brendshme (Rregullorja e Brendshme) parashikon rregullat dhe procedurat e funksionimit të qendrës së ndërmjetësimit (Qendra e Ndërmjetësimit), përgjegjësitë e Administratorit të Qendrës së Ndërmjetësimit dhe ndërmjetësve që bashkëpunojnë me të, si dhe çështje të tjera teknike dhe administrative. Përgatitja e kësaj Rregulloreje të Brendshme është mbështetur, përveç dispozitave ligjore në fuqi, në shembuj të rregulloreve të përdorura më parë nga Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Konflikteve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve dhe Qendra për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve Mitrovicë.

Kjo Rregullore e Brendshme, së bashku me Kodin e Etikës bashkangjitur si Shtojca 1, parashikon gjithashtu rregullat dhe standardet për tu respektuar në proceset e ndërmjetësimit që zhvillohen në Qendrën e Ndërmjetësimit, nga momenti i referimit të çështjes deri në momentin e përfundimit të procesit të ndërmjetësimit.

Në kontekstin e Qendrës së Ndërmjetësimit, “ndërmjetësimi” është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans, për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që është brenda kuadrit ligjor.

Në dallim nga proceset gjyqësore ose të arbitrazhit kur një gjykatës ose arbitër vendos për rezultatin e një mosmarrëveshjeje bazuar në rregulla dhe ligj, ndërmjetësimi është një procedurë e bazuar në interes të palëve që i lejon ata të marrin përgjegjësinë e pasojave dhe të kapërcejnë mosmarrëveshjen e tyre, duke u bërë bashkë në një mjedis të sigurt dhe duke shprehur dhe ndarë mundësitë për një zgjidhje të përbashkët të mosmarrëveshjes së tyre. Një ndërmjetës është një profesionist, qëllimi i të cilit është të mbështesë palët në komunikimin dhe negociimin midis tyre. Ndërsa ajo/ai kontrollon procesin, janë palët ato që janë përgjegjëse për rezultatin pozitiv ose negativ të negociatave.

II. Baza Ligjore

Ky seksion përmend bazën kryesore ligjore që rregullon funksionimin e procesit të ndërmjetësimit në Shqipëri.

- Ligji Shqiptar për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, nr. 10385, datë 24.02.2011, i ndryshuar.

Ligji Shqiptar për Ndërmjetësimin, i cili është ndryshuar së fundmi më 17 maj 2018, përbën kuadrin kryesor ligjor për funksionimin e shërbimit të ndërmjetësimit. Ai përmban dispozitat themelore që duhet të ndiqen nga ndërmjetësi, si dhe bazën për secilin hap të procesit të ndërmjetësimit, duke filluar nga referimi i çështjes, caktimi i një ndërmjetësi, procedura e ndërmjetësimit dhe momenti i arritjes së një marrëveshjeje ndërmjetësimi.

Sa i përket çështjeve të ndërmjetësimit të referuara nga gjykata ose prokuroria, neni 1/2 (b) i Ligjit për Ndërmjetësim parashikon:

“Ndërmjetësim i referuar nga gjykata ose prokurori është një procedurë ndërmjetësimi e filluar pas vënies në dijeni të palëve ndërgjygjëse nga gjykata mbi mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, pranimit të palëve dhe kalimit nga gjykata të çështjes për ndërmjetësim, në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Lidhur me fushën e zbatimit të ndërmjetësimit, neni 2 i Ligjit për Ndërmjetësimin përcakton një kuadër të përgjithshëm të fushave që mund të mbulohen nga ndërmjetësimi:

“2. Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, si dhe të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private.

3. Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e viktimës akuzuese, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë. Për ndërmjetësimin në çështjet penale me të mitur zbatohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.”

Për sa i përket procesit të ndërmjetësimit në përgjithësi, sërish neni 2 i Ligjit për Ndërmjetësimin përcakton si vijon:

“4. Gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht njofton, udhëzon dhe, sipas rastit, informon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa u kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve:

a) Në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;

b) Në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes;

c) Me karakter pasuror, që lidhen me të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuese, si dhe ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues.

5. Në rastin e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur procedimi penal ka nisur, gjykata detyrimisht njofton dhe udhëzon palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.”

- Kodi i Procedurës Civile, ligji rr. 8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar.

Ligji për Ndërmjetësimin referon te Kodi i Procedurës Civile për procedurat që duhet të ndiqen nga gjykata kur referohen çështje civile në ndërmjetësim. Neni 13 i Ligjit për Ndërmjetësimin

përcakton: “Gjykata, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, njofton dhe udhëzon palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi ... dhe kur palët bien dakord pezullon gjykimin duke u caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes, por jo më shumë se 30 ditë.”

Në veçanti, nenet 4, 25, 125 dhe 158/ç të Kodit të Procedurës Civile parashikojnë se si gjykata duhet të përpqet të pajtojë palët dhe/ose t'i referojë ato në ndërmjetësim, si dhe procesin e referimit.

Para parashikimit të dispozitave të hollësishme për procesin që gjykata ndjek për t'i referuar çështjet në ndërmjetësim, neni 158/ç parashikon: "Në secilën fazë të gjykimit, gjykata njofton palët mbi mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes përmes ndërmjetësimit dhe nëse ata bien dakord, gjykata e kalon çështjen në ndërmjetësim.

- Kodi i Familjes, nr. 9062, datë 08 maj 2003.

Neni 125 i Kodit të Familjes parashikon si më poshtë:

"Zgjidhja e martesës me pëlqimin e ndërsjellë: Kur bashkëshortët bien dakord të zgjidhin martesën, ata paraqesin në gjykatë një kërkesë për miratim, së bashku me një draft marrëveshjeje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose përfaqësuesit e tyre. "

Në vijim, nenet 134 - 136 të Kapitullit V të Kodit të Familjes parashikojnë për përpjekjet për pajtim që duhen ndërmarrë nga gjykata. Kjo referencë ligjore mund të përdoret nga gjykatësit për t'i drejtuar palët në Qendrën e Ndërmjetësimit.

- Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Ligji Nr. 37/2017, datë 30 Mars 2017

Kodi Penal për Drejtësinë e të Miturve është një ligj i kohëve të fundit dhe shumë i rëndësishëm, ku ndërmjetësimi i jepet një rol kyç në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Kod e përkufizon ndërmjetësimin në nenin 3/13 të tij si “procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësish dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.”

Rëndësi i kushtohet ndërmjetësimit edhe në rastet e zbatimit të masës së shmangies. Neni 58/3 parashikon si vijon: “Në rastin e vendosjes së masës së shmangies prokurori merr vendimin për

mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj dhe lidh një marrëveshje me të miturin për llojin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin.”

Gjithashtu, së bashku me drejtësinë restauruese, Kodi e parashikon ndërmjetësimin si një masë alternative e mundshme që do të parandalonte që ndjekja penale të ndodhë.

- Ligje të tjera

Dispozita të tjera që parashikojnë rregullime lidhur me ndërmjetësimin janë Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, etj.

III. Rregullat e Përgjithshme të Qendrës së Ndërmjetësimit

Qendra e Ndërmjetësimit synon të mbështesë përdorimin e ndërmjetësimit si një alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në Shqipëri, dhe të lehtësojë referimin e çështjeve nga gjykata, prokuroria, autoritetet e policisë ose ndonjë autoritet tjetër publik përkatës sa herë që ata e konsiderojnë rastin të përshtatshëm për ndërmjetësim.

Qendra gjithashtu funksionon edhe si hapësira fizike për ndërmjetësit që të kryejnë ndërmjetësime të marra në mënyrë private, duke ofruar mbështetje logjistike dhe teknike me qëllim lehtësimin e zgjidhjes pozitive të mosmarrëveshjes.

Shërbimi i ndërmjetësimit i ofruar nga ndërmjetësit në ambientet e Qendrës së Ndërmjetësimit sigurohet në përputhje me Ligjin e Ndërmjetësimit dhe operohet nga CSSP në kuadër të projektit "ALB-18/0001 Forcimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri".

1) Orari i punës

Orari i punës së Qendrës së Ndërmjetësimit do të jetë 08:00 - 17:00, nga e Hëna deri të Premten.

2) Menaxhimi

Qendra e Ndërmjetësimit menaxhohet nga një administrator/e. Administratori/ja do të jetë pikë kryesore kontakti për të gjithë institucionet, ndërmjetësit, partnerët dhe çdo palë tjetër

e interesuar që mund t'i drejtohet Qendrës së Ndërmjetësimit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Administratorit janë si më poshtë:

1. Pranon në formë elektronike ose fizike dhe regjistron të gjitha çështjet që referohen për ndërmjetësim dhe ruan dokumentet shoqëruese të tyre.
2. Bashkëpunon me gjykatën, zyrën e prokurorisë, autoritetet e policisë dhe/ose ndonjë entitet tjetër referues, për rastin e referuar, duke marrë informacionin përkatës për rastet e referuara për ndërmjetësim, si dhe duke ofruar informacionin dhe dokumentacionin përkatës për mbarrëvajtjen e procesit të ndërmjetësimit.
3. Merr kontaktet e palëve të përfshira në çështje dhe i fton ata në Sesionin Informues.
4. Organizon Sesionin Informues për palët, në secilin proces të ndërmjetësimit dhe i informon ata siç duhet për mënyrat dhe përfitimet e procesit të ndërmjetësimit.
5. Koordinon kalendarin e seancave të ndërmjetësimit që do të zhvillohen në Qendrën e Ndërmjetësimit.
6. Mban një bazë të dhënash case-log për secilin rast nga fillimi deri në përfundimin e tij, duke pasqyruar të gjitha detajet e nevojshme të procesit të ndërmjetësimit. Këto detaje do të trajtohen me konfidencialitet të plotë nga Qendra e Ndërmjetësimit.
7. Informon institucionin referues, kur kërkohet, dhe, në çdo rast në mënyrë të rregullt periodike, për statistikën rreth rasteve të referuara dhe/ose për progresin e procesit të ndërmjetësimit të ndonjë rasti specifik.
8. Mirëmban dhe administron dosjet personale të ndërmjetësve, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre (kopje të kartës së identitetit, CV, kopjet e licencave dhe dokumente të ngjashme që janë të nevojshme për angazhimin e tyre në Qendrën e Ndërmjetësimit.
9. Ofron ndihmë administrative dhe logjistike për ndërmjetësit që trajtojnë raste.
10. Mban kopje të të gjithë dokumentacionit të prodhuar gjatë një procesi ndërmjetësimi dhe i ruan ato në arkivin e Qendrës së Ndërmjetësimit.

11. Kontribuon në përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve informuese për ndërmjetësimin si, fletëpalosje, ligjin për ndërmjetësimin, broshura për palët dhe institucionet e interesuara si dhe promovon ndërmjetësimin në Gjykatë si një mundësi alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
12. Siguron që Qendra e Ndërmjetësimit të ofrojë kushte të mira dhe të përshtatshme për seancat e ndërmjetësimit.
13. Kryen detyra të tjera që lidhen me menaxhimin e veprimtarisë së Qendrës së Ndërmjetësimit.

3) *Lista e ndërmjetësve*

Çdo ndërmjetës i licencuar nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, i regjistruar me NIPT për qëllime fiskale dhe anëtar i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve lejohet të kërkojë të jetë pjesë e listës së ndërmjetësve që bashkëpunojnë me Qendrën e Ndërmjetësimit dhe të marrë raste.

Në përputhje me qëllimin e Kodit Shqiptar të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe udhëzimet e Ministrisë së Drejtësisë që kërkojnë trajnime specifike për ndërmjetësit që trajtojnë çështje penale të të miturve, Qendra e Ndërmjetësimit parashikon që përveç një liste të përgjithshme, të ketë edhe një të dytë për ndërmjetësit e trajnuar posaçërisht në ndërmjetësimin e çështjeve penale dhe të të miturve.

Shpërndarja e rasteve të ndërmjetësit do të bëhet në përputhje të plotë me rregullat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore të Brendshme dhe me ndryshimet e mundshme në të ardhmen.

CSSP do të organizojë trajnime fillestare dhe/ose të tjera të veçanta për ndërmjetësit sipas nevojave të tyre më të ndjeshme për rritjen e kapaciteteve, në të cilat ftohen të marrin pjesë të gjithë ndërmjetësit e angazhuar në mënyrë aktive me Qendrën e Ndërmjetësimit.

Gjatë kohës së angazhimit në Qendrën e Ndërmjetësimit për të ofruar shërbime të ndërmjetësimit, ndërmjetësit duhet të ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin e

ndërmjetësimit, në ligje të tjera të rëndësishme dhe në këtë Rregullore të Brendshme bashkë me anekset e saj.

4) *Standardi i ndërmjetësimit*

Për të siguruar standardin më të lartë të ndërmjetësve, do të kërkohet që ndërmjetësit që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me Qendrën, të marrin pjesë në trajnimet dhe aktivitetet për rritje kapaciteti, të ofruara nga CSSP.

IV. Menaxhimi i rasteve

1) Fillimi i ndërmjetësimit të çështjes

Për çështjet e referuara nga gjykata, prokuroria, autoritetet e policisë ose autoritetet e tjera shtetërore, autoriteti referues i fton palët të ndërmjetësojnë çështjen e tyre dhe i referon ato në Qendrën e Ndërmjetësimit. Institucioni harton një vendim të ndërmjetëm ose një letër referimi që shoqëron dosjen e çështjes referuar Qendrës së Ndërmjetësimit. Në këtë vendim/letër referimi, institucioni përcakton afatin kohor brenda të cilit duhet të përfundojë procesi i ndërmjetësimit, duke marrë parasysh nevojat kohore të një procesi ndërmjetësimi.

Në rastet e referuara nga ndonjë burim tjetër, përfshirë avokatët, OJQ-të, bizneset, etj., palët janë të mirëpritura të ndërmjetësojnë mosmarrëveshjen e tyre në Qendrën e Ndërmjetësimit. Subjektet referuese ose vetë palët janë të ftuar të paraqesin një njoftim në Qendrën e Ndërmjetësimit duke shprehur dëshirën që çështja e tyre të trajtohet përmes ndërmjetësimit në mjediset e Qendrës. Administratori është përgjegjës për mbajtjen e kopjeve të dokumenteve referuese në arkivin e Qendrës së Ndërmjetësimit.

2) Pranimi i çështjes

Me marrjen e rastit, Administratori regjistron të dhënat e duhura në bazën e të dhënave për rastet, hap një dosje të rastit dhe nënshkruan fletën e pranimit bashkë me palën që dorëzon rastin. Fleta e pranimit nënshkruhet në dy kopje origjinale, njëra kopje qëndron në Qendrën e Ndërmjetësimit dhe tjetra i jepet institucionit/subjektit referues.

3) Seancat informuese

Pas mbledhjes së informacionit për palët nga subjektet/institucionet referuese, Administratori vazhdon me përgatitjen e njoftimeve për të ftuar palët të marrin pjesë në seancën informuese. Një seancë e tillë informuese zhvillohet ose në ambientet e Qendrës së Ndërmjetësimit ose online (nëpërmjet internetit) përmes llogarisë profesionale Zoom të Qendrës së Ndërmjetësimit, duke u gjykuar rast pas rasti se cila vlerësohet mënyra më e përshtatshme nga Administratori dhe palët.

Administratori kontakton palët përmes e-mailit, thirrjeve në telefon, ose çdo mjet tjetër komunikimi të përshtatshëm.

Në rastin kur palët nuk i përgjigjen ftesës së parë për të marrë pjesë në seancën informuese, as nuk paraqiten në takimin informues, Administratori i fton ata për herë të dytë. Në total, Administratori i fton palët dy (2) herë në seancat informuese.

Në seancën informuese, Administratori mirëpret palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre ligjorë, merr informacione të përgjithshme lidhur me rastin, shpjegon përfitimet e ndërmjetësimit dhe zhvillimin e procesit të ndërmjetësimit, mban marrëveshjen e nënshkruar të palëve ku bien dakord për të hyrë në ndërmjetësim (në rastet e seancave informuese online-nëpërmjet internetit-, Administratori merr fillimisht një miratim/marrëveshje gojore të palëve për të hyrë në ndërmjetësim dhe dakordësohet për një orë dhe datë sa më shpejt të jetë e mundur pas seancës informuese online që palët ta nënshkruajnë atë fizikisht pranë Qendrës së Ndërmjetësimit), u paraqet atyre listën e ndërmjetësve, mirëpret një kërkesë të përbashkët të palëve për një ndërmjetës të caktuar ose cakton një ndërmjetës që është te lista duke respektuar rendin alfabetik.

4) Marrëveshja për të marrë pjesë në ndërmjetësim

Para procesit dhe pas seancës informuese, palët nënshkruajnë një marrëveshje për të zgjidhur çështjen e tyre me ndërmjetësim, përveç rasteve siç parashikohen në nenin 17/3 të Ligjit për Ndërmjetësimin.

Modeli i një marrëveshje të tillë sigurohet nga Qendra e Ndërmjetësimit dhe nënshkruhet nga palët. Kjo marrëveshje do të përmbajë logot e CSIP, DHKN dhe AFCR, si partnerët implementues të projektit.

5) Caktimi i ndërmjetësit

Gjatë seancave informuese, dhe pasi palët bien dakord të hyjnë në ndërmjetësim, Administratori u prezanton palëve listën e ndërmjetësve që bashkëpunojnë me Qendrën (Lista) (e cila përfshin një përshkrim të shkurtër për secilin ndërmjetës) dhe i fton ata që së bashku të caktojnë një.

Dhënia e rastit një ndërmjetësi të caktuar me kërkesën e njëres palë lejohet atëhere kur pala tjetër, e informuar nga Administratori për kërkesën dhe zgjedhjen, pajtohet në mënyrë të qartë.

Në rastin kur palët nuk kanë preferencë për një ndërmjetës të caktuar, ose nuk arrijnë të bien dakord për një, ndërmjetësi caktohet nga Administratori me sistem rotacioni duke respektuar rendin alfabetik. Të gjithë ndërmjetësit që bashkëpunojnë me Qendrën mund të zgjedhin të regjistrohen në “Listën e Përgjithshme”, “Listën e Ndërmjetësve për Çështje Penale” dhe/ose “Listën e Ndërmjetësve për të Mitur”, në përputhje me formatin e shprehjes së interesit. Çdo ndërmjetës ka të drejtë të regjistrohet në një apo të gjitha listat e lartpërmendura. Për tu regjistruar te Lista Ndërmjetësve për të Mitur, ndërmjetësit duhet të vërtetojnë që kanë ndjekur trajnimet e duhura në këtë fushë duke provuar pjesëmarrjen me dokumentet përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore.

Administratori i telefonon ndërmjetësit sipas rregullit të lartpërmendur dhe i pyet për disponueshmërinë e tyre.

Administratori e kontakton ndërmjetësin dy (2) herë në total. Në rast se ndërmjetësi nuk përgjigjet herën e parë, Administratori ruan regjistrimin e thirrjes (duke regjistruar kohën kur është thirrur ndërmjetësi, por nuk ka marrë përgjigje nga ana e tij / saj) dhe lë një hapësirë kohore prej tre (3) orësh deri në përpjekjen e dytë për ta kontaktuar. Pasi pret përsëri për tre (3) orë, Administratori kalon te ndërmjetësi tjetër në listë.

Në rastin kur ndërmjetësi është a) *jashtë vendit dhe/ose* b) *nuk është në gjendje ta marrë rastin (për arsye shëndetsore)*, Administratori telefonon ndërmjetësin tjetër në listë sipas rendit alfabetik. Rasti tjetër që vjen pas këtij rasti që përmendëm do të ofrohet ndërmjetësit, i cili për arsyet e lartpërmendura nuk mundi ta trajtojë rastin.

Kur panifikohen seancat e ndërmjetësimit me palët, Administratori dhe ndërmjetësi marrin parasysh kufizimet kohore, p.sh afatin kohor të vendosur nga institucioni/subjekti referues në vendimin e tij/saj për referim, afatet ligjore, etj.

Seancat e ndërmjetësimit mbahen ose në ambientet e Qendrës së Ndërmjetësimit ose online nëpërmjet internetit përmes llogarisë profesionale Zoom të Qendrës së Ndërmjetësimit. Në të dy rastet, Administratori i ofron të gjithë ndihmën teknike ndërmjetësit të çështjes dhe palëve gjatë gjithë procesit të ndërmjetësimit.

6) Bashkëndërmjetësim

Në rastet e ndonjë a) *rasti shumë të komplikuar* (i cili vlerësohet nga stafi i CSSP bashkë me ndërmjetësin përkatës), ose b) *kur ndërmjetësi nuk ka përvojë të mëparshme*, CSSP mund të autorizojë bashkëndërmjetësim.

7) Përfundimi i procesit të ndërmjetësimit

Në rastin kur Palët arrijnë një marrëveshje, një kopje me shkrim e kësaj të fundit duhet të printohet dhe të nënshkruhet në aq kopje sa është e nevojshme: një për secilën palë, një për t'u dorëzuar te institucioni/subjekti referues dhe një kopje qëndron në Qendrën e Ndërmjetësimit.

Në rastin kur nuk arrihet një marrëveshje, një deklaratë për mosarritjen e marrëveshjes dhe për përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit duhet të firmoset nga palët ose nga njëra prej palëve dhe printohet po në aq kopje sa është e nevojshme.

8) Komunikimi i rezultateve të ndërmjetësimit

Në fund të procesit të ndërmjetësimit, Administratori përgatit një fletë dorëzimi për institucionin/subjektin referues për rezultatin e ndërmjetësimit (pozitiv apo negativ) dhe I bashkangjit një kopje të marrëveshjes së ndërmjetësimit apo deklaratës bashkë me dokumentet përkatëse të dosjes së rastit..

Fleta e dorëzimit nënshkruhet nga Administratori dhe personi që e merr dosjen e rastit nga institucioni/subjekti përkatës. Kjo fletë dorëzimi nënshkruhet në dy kopje origjinale, njëra qëndron

në Qendrën e Ndërmjetësimit dhe tjetra shkon në institucionin/subjektin përkatës. Në rastet me të mitur të referuara nga gjykata ose prokuroria, kur ekziston një detyrim ligjor për ndërmjetësin që të njoftojë direkt vetë institucionin për përfundimin e çështjes, ndërmjetësi procedon me kryerjen e një njoftimi të tillë. Në këto raste, ndërmjetësi sigurohet që të informojë edhe Qendrën e Ndërmjetësimit përkatësisht.

Kthimi i dosjes së rastit te institucioni/subjekti referues duhet të kryhet brenda afateve të dhëna nga institucioni përkatës, gjithsesi maksimalisht brenda 5 ditësh pune, pas përfundimit të procesit të ndërmjetësimit.

9) Vlerësimi i procesit të ndërmjetësimit

Në fund të procesit të ndërmjetësimit, Administratori u shpërndan palëve një pyetësor vlerësimi i cili plotësohet në formë anonime, pas përfundimit të procedurës së ndërmjetësimit. Administratori u shpjegon palëve qëllimin e pyetësorit dhe i informon ata për natyrën konfidenciale të tij. Plotësimi i pyetësorit është vullnetar për palët.

V. Tarifat

Para nisjes së procesit të ndërmjetësimit, gjatë seancave informuese, palët dhe ndërmjetësi informohen siç duhet nga Administratori për sa i përket procedurës së pagesës dhe metodës që do përdoret, nëse aplikohet.

1) Legjitimimi

Qendra e Ndërmjetësimit është përgjegjëse për pagesën e tarifave të ndërmjetësimit direkt te ndërmjetësit për të gjitha llojet e çështjeve të ndërmjetësimit, përveç sa parashikohet në paragrafin më poshtë në këtë seksion. Tipologjia e çështjeve të ndërmjetësimit përfshin por pa u kufizuar në to, çështjet civile, çështjet e së drejtës familjare, çështjet të pronësisë, çështjet e korporatave dhe ato tregtare, si dhe çështjet penale deri në masën e lejuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe nga legjislacioni tjetër përkatës.

Për të gjitha rastet e ndërmjetësimit kur të gjitha palët në ndërmjetësim janë njësi që kanë një numër NIPT-i dhe të regjistruar në autoritetet tatimore shqiptare, këto palë do të jenë përgjegjëse

të paguajnë vetë tarifën e ndërmjetësimit ndërmjet tyre. Qendra e Ndërmjetësimit nuk do të ofrojë pagesa ose rimbursim për pagesën e tarifës së ndërmjetësimit në këto raste.

2) Shuma e tarifës së ndërmjetësimit

Shuma e tarifës së ndërmjetësimit për rastet e trajtuara në Qendrën e Ndërmjetësimit do të jetë 11.000 lekë për rast (jo çdo seancë) për shërbimet e ndërmjetësit, pa TVSH. Në rast të bashkëndërmjetësimit, të dy ndërmjetësit do të paguhen secili 11.000 lekë, sic thuhet më lart. Një tarifë e tillë mund të modifikohet në formë të shkruar, sipas kësaj rregulloreje në rast se një modifikim i tillë bëhet kërkesë për të qëndruar në përputhje me kërkesat ligjore që ekzistojnë në Republikën e Shqipërisë.

3) Afati

Afati aktual i rënë dakord gjatë së cilit Qendra e Ndërmjetësimit do të vazhdojë të ofrojë pagesën e tarifave të ndërmjetësimit siç përcaktohet më sipër është deri më 28 shkurt 2021. Në rast të zgjatjes së këtij afati, CSSP do të modifikojë këtë pjesë në përputhje me rrethanat dhe kushtet përkatëse siç është rënë dakord me partnerët e projektit dhe donatorin / et.

4) Procedura e pagesës

Për rastet e ndërmjetësimit të përmendura në paragrafin e parë të seksionit "Legjitimiteti" si më lart, Qendra e Ndërmjetësimit mund të mbulojë shpenzimet pasi palët dhe ndërmjetësi i çështjes të bëjnë një kërkesë zyrtare për rimbursimin e shpenzimeve, përkatësisht të paraqesin: Kërkesë Fondi për Shërbimin e Ndërmjetësimit (kërkesë për rimbursim nga palët) dhe Kërkesë për Pagesë për Ndërmjetësim (faturë nga ndërmjetësi). Pagesa bëhet nga Financieri i CSSP pasi të plotësohen dhe pranohen format e lartpërmendura, dhe pasi të jenë përmbushur marrëveshjet kontraktuale me ndërmjetësin (it) të angazhuar në këtë rast.

Për rastet e ndërmjetësimit ndërmjet palëve që kanë NIPT siç përcaktohet dhe më lart, palët janë përgjegjëse ta paguajnë tarifën e ndërmjetësimit direkt te ndërmjetësi.

Dokumentacioni për tarifën e ndërmjetësit përmban: vërtetimin bankar dhe një faturë të lëshuar nga ndërmjetësi për shërbimet e tij / saj. Kjo formë e faturës përfshin informacionin e mëposhtëm:

të dhënat personale të ndërmjetësit, të dhënat personale të palës (ëve), numrat e referimit (të dyja, gjykata / prokuroria dhe numrin e ndërmjetësimi), datat e përfundimit të procedurës së ndërmjetësimi, dhe tarifën për pagesë.

Në përputhje me praktikën standarde të ndërmjetësimi, ndërmjetësi ka të drejtën e rimbursimit vetëm kur rasti hyn në procesin e ndërmjetësimi.

Pagesa për shërbimin e ndërmjetësit behet edhe në rastet kur çështja nuk zgjidhet me sukses.